

kryeje investime ne sektoret e prodhimeve e/ose sherbimeve e/ose tregtise, turizmit, Brenda ose jashte teritorit te shtetit Shqiptar.

Gjithashtu shoqeria mund te kerkoje financime nga ente publike, private ose persona fizike e juridike, kombetare ose nderkombetare, sipas legjislacionit ne fuqi.

### **ADMINISTRATORI**

Ne fillim te aktivitetit te shoqerise do te veproje vete. Me vone dhe kurdohere me miratimin tim, mund te vendose administrator te shoqerise nje person tjeter.

### **PERGJEGJESIA**

Mbaj pergjegjesi ligjore si pronar dhe ortak i vetem i shoqerise per te gjitha demet qe mund te shkaktohen nga veprimtaria e kesaj shoqerie.

### **ORTAK I VETEM**

**EMA COKU**

*EMA COKU*



# STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "B.S.K"

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "B.S.K" sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Kjo shoqeri krijohet me ortak te vetem Ema Coku

Ajo e ka seline ne rrugen "Pjeter Bogdani" pall 20/4 ap 4B.

Shoqeria ka te drejte te cele filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve te tjera ku do te hapen.

Administrator i shoqerise eshte znj. Ema Coku

### Neni 2

Shoqeria "B.S.K" sh.p.k e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Shoqeria eshte person juridik .Ajo e fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne gjykate.

### Neni 3

Shoqeria "B.S.K" krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje kohezgjatje mbi 10 vjet..

Shoqeria "B.S.K" mund ta zgjase afatin e aktivitetin te saj ose te mbylle aktivitetin e veprimtarise se saj para ketij afati, sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kriterëve qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi.

### Neni 4

Shoqeria "B.S.K" per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet , pergjigjet vetem me pasurine e saj.

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie pergjigjet per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurine e tij qe nuk eshte futur ne kapitalin e kesaj shoqerie.

Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk e pengon ortakun e vetem te kete pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesia jashte kesaj shoqerie.



## **Neni 5**

### **Objekti i aktivitetit te shoqerise**

Shoqeria do te kete objekt te aktivitetit te saj;

-Realizimin stabilimenteve industriale dhe prodhimin e makinerive e paisjeve elektrike e mekanike, ndertimi, paneleve elektrike, konstruksioneve metalike etj.

-Ndertim objektesht dhe komplekse objektesh industriale, turistike, banimi socialkulturore, te infrastructures.Ndertim objektesh civile dhe ekonomike, rruge , ura ujesjelles dhe kanalizime, punime veprash ujitesse dhe kanalizime, beton arme, punime druri.Rikonstruksion godinash civile dhe mirembajtjen e tyre,zhvillim dekori ne mjediset urbane.

-Importimin, eksportimin dhe tregtimin e te gjitha artikujve industriale, te makinerive qe kane lidhje me sektoret e industries, te artizanatit,te tregtise se bujqesise, blegtorise si dhe pjeset e kembimit te tyre, materialet e ndertimit dhe te instalimeve te ndryshme etj.

-Transportin e ketyre artikujve, te ketyre lendeve te para ose te transformuara per nevojat vetjake te zhvillimit te aktivitetit te shoqerise etj.

-Lidhje te kontratave komisionere per blerje, shitje dhe transportin e ketyre artikujve dhe/ose lendeve te parae/ose te transformuara.


-Pavec kesaj shoqeria mund te kryeje noperacione me pasuri te tundshme e te patundshme si dhe financiare, qe shihen te arsyeshme per zhvillimin e aktivitetit te saj, kerkoje e/ose te marre pjese e /ose te kryeje investime ne sektoret e prodhimeve e/ose sherbimevee/ose tregtise, turizmit Brenda ose jashte teritorit te shtetit shqiptar.

-Gjithashtu shoqeria mund te kerkoje financime nga ente publike, private, ose persona fizike dhe juridike, kombetare ose nderkombetare, sipas legjislacionit ne fuqi.

### **MARRDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE KAPITALI THEMELTAR**

## **Neni 6**

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie ne te holla eshte 100000 leke. Ky kapital themeltar zoterohet nga ortaku i vetem. Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme perkundrejte personave te trete. Transferimi i kapitalit ne favor te nje personi te trete behet gjithmone me akt



noterial. Te gjitha veprimet e shoqerise me kapitalin themeltar behen me miratimin e ortakut te vetem.

#### **Neni 7**

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen ne nje regjister te vecante.

#### **Neni 8**

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqerise do te disponohet nga ortaku i vetem.

#### **Neni 9**

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit te shoqerise duhet te perfundoje Brenda muajit Mars te vitit pasardhes. Bilanci i aktivitetit financiar mund te behet nga vete ortaku ose nga eksperte te caktuar prej tij.

#### **Neni 10**

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj ne perputhje me rregullat nne fuqi. Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre, caktohen nga ortaku.

#### **Neni 11**

Shoqeria i disponon plotesisht mjetet e saj financiare.


### **TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT**

#### **Neni 12**

Ortaku i vetem ka tre te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra :

-Te marre pjese ne administrimin e veprimtarise ekonomike-tregtare te shoqerise ne perputhje me statutin.

-te kerkoje ti jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e perpunuara nga shoqeria (bilanci, libra llogarie).



-Te mbylle shoqerine kur cmohet e arsyeshme prej tij.

### **Neni 13**

Ortaku i vetem ka keto detyra kryesore:

-Te zbatoje kriteret e caktuara nga ligji ne fuqi, per punetoret dhe nepunesit qe punesohen ne shoqeri.

## **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQERISE**

### **Neni 14**

Administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat qe te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marrdhenie me personat e trete.

Shoqeria merr persiper te gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e administratorit.

### **Neni 15**

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete, kur gjate veprimeve te tyre shkelin ligjin, statutin ose per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

### **Neni 16**

Marrdheniet e punes me punetoret qe do te punesohen prane shoqerise "B.S.K" sh.p.k rregullohen me kontraten individuale qe do te blidhet me sejcilin prej tyre.

## **MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE**

### **NENI 17**

Veprimtaria e shoqerise pushon ne mbarimin e afatit te percaktuar ne statut, nqs ortaku i vetem me vullnetin e tij te lire nuk e zgjat kete afat.

Ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit te parashikuar ne kete statut kur per kete merr vendim ortaku i vetem. Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortaku vendos shnderrimin e shoqerise nga sh.p.k ne nje lloj tjeter shoqerie.

## **Neni 18**


Kur shoqeria likujdohet plotesisht, ortaku i vetem krijon komisionin e likuidimit. Pasuria e shoqerise qe ngelet pas shlyerjes se detyrimeve te saj i kalon ortakut te vetem.

Pasuria qe eshte futur ne shoqeri me te drejta shfrytezimi i kthehet pronarit te saj.

## **ORTAKU I VETEM**

**Ema COKU**

EMA COKU



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 3199 REP.

Tirane, me 17.09.2001-09-17



VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 17.09.2001, para meje noteres Elida Take u paraqit personalisht Z. Erna Çoku, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e panjohur prej meje por per identitetin e saj u sigurova nga pasaporta me nr. 0472404 e cila nenshkroi ne prezencen time dokumentin e mesiperm dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e saj ne baze te ligjit "Per Noterine"

NOTERE  
ELIDA TAKE

